# Buletin, botimi i 13të - prill 2017

RisiAlbania
Partner for Growth

Duke punuar së bashku me partnerët nga sektori privat, publik dhe nga shoqëria civile për nxitjen e hapjes së vendeve të punës dhe ndërmjetësimin efikas për punësim, RisiAlbania synon të vërë tregun e punës në dobi të rinisë shqiptare.

**Kohëzgjatja e projektit**:
Nëntor 2013 – Tetor 2017

**Adresa & Kontaktet:**
Rr. Ismail Qemali, P18, H.3, Apt. 15 Tirana, Albania
Tel: +355 (0) 422 48 52
Email:info@risialbania.al

## Gazeta AGROBIZNESI

Gazeta "AGROBIZNESI" konsiderohet si burimi kryesor i informacionit për popullsinë rurale që merret me bujqësi në Shqipëri mbi zhvillimet dhe problemet aktuale të sektorit. Ajo botohet dy herë në muaj dhe shpërndahet në 2,000 fshatra në të gjithë vendin.

Risi është duke kontribuar në misionin e gazetës për të shpërndarë informacion të rëndësishëm për fermerët dhe agro-bizneset duke i përqëndruar ndërhyrjet e saj në sektorin e bujqësisë. Për sa më sipër, gazeta është një mjet i shkëlqyer për shpërndarjen e informacionit që ka të bëjë me përmirësimin e cilësisë së bimëve aromatiko- mjekësore, një nga ndërhyrjet e RisiAlbania-s. Po ashtu, shkëmbimi i informacionit në lidhje me standardet dhe proceset e certifikimit si edhe me aksesin ndaj mundësive të financimit janë tema mjaft të rëndësishme për fermerët dhe agro-bizneset.

Puna së bashku me gazetën "AGROBIZNESI" jo vetëm që siguron kalimin e informacionit të duhur tek fermerët dhe agro-bizneset, por edhe shërben si një mjet për projektin për të zgjeruar disa nga ndërhyrjet e tij.

## Guidat Turistike Shqiptare – gati për t'u kualifikuar dhe certifikuar

Kurrikula për 3 kategoritë e guidave turistike në Shqipëri u miratua në janar të vitit 2017 me urdhër të përbashkët të MZHETTS dhe MMSR. Kjo kurrikul e unifikuar u përgatit nga NATGA me mbështetjen e Projektit RisiAlbania dhe kurset e trajnimit për guidat turistike parashikohet të zbatohen nga muaji prill 2017 e në vazhdim.

Përveç kësaj, MZHETTS ka certifikuar 159 guida shqiptare turistike, të cilët janë përfshirë në regjistrin e guidave turistike të Shqipërisë. I gjithë procesi i aplikimit, testimi (me shkrim dhe me gojë) u asistua nga përfaqësuesit e NATGA, të cilët ishin pjesë e katër komisioneve të vlerësimit gjatë muajit shkurt 2017.

## Mbështetje me Ekspertizë Zvicerane të Klasit Botëror për sistemin e Klasifikimit të Hoteleve në Shqipëri

Procesi i krijimit të sistemit për klasifikimin e hoteleve në Shqipëri, i udhëhequr nga MZHETTS, do të jetë përpjekja e parë e këtij lloji në vend. Si hap i parë, në muajin mars kompania e mirënjohur në mbarë botën *Lausanne Hospitality Consulting (LHC),* me mbështetjen e RisiAlbania, kreu takime me aktorët kryesorë të turizmit në Shqipëri, për të ofruar ekspertizën e saj në lidhje me sistemin e klasifikimit të hoteleve.

## Ngjarjet e ardhshme

Pritet që gjatë muajit maj, Shqipëria të vizitohet nga një kompani BPO globale, investitore në sektorin e BPO.

Deri në fund të muajit maj moduli i përmirësuar i ndërmjetësimit të SHKP, Sistemi i Informacionit për Punësimin do të funksionojë *live* (në kohë reale) dhe do të përdoret nga të gjitha Zyrat e Punës.

# Nënsektori i Nënkontraktimit të Shërbimeve të Biznesit (Business Process Outsourcing)

RisiAlbania nëpërmjet kompanisë konsulente ndërkombëtare, Avasant LLC, mbështet ngritjen e kapaciteteve të stafit të AIDA, FIAA dhe AOA për promovimin e investimeve; dhe mundësoi pjesëmarrjen e tyre në panairin e tregtisë CCW për call centers të organizuar në Berlin gjatë periudhës 20-23 shkurt, 2017. Qëllimi ishte promovimi i Shqipërisë tek investitorët botëror si një destinacion për investime të reja në sektorin BPO. Si rezultat, 15 kompani kanë shprehur interes për ta përfshirë Shqipërinë në rrjetin e vendeve që do të vlerësohen nga ata para zgjerimit dhe katër të tjera për ta vizituar atë së shpejti.

Risi ka punuar ngushtë me Sekretariatin e Këshillit Shqiptar të Investimeve duke ju ofruar ekspertizën e tyre në sektorin e BPO. Si rezultat, me datë 15 shkurt 2017 Këshilli Shqiptar i Investimeve organizoi takimin e tij tremujor për të diskutuar mundësitë e rritjes së sektorit BPO dhe nevojën për diversifikimin e shërbimeve. Kjo ishte hera e parë që Sekretariati i Këshillit të Investimeve mblidhej në një takim për të diskutuar vetëm për sektorin BPO – një hap i rëndësishëm për industrinë BPO në Shqipëri.

Në mes të muajit shkurt Kompania globale BPO "Southerland" bëri një vizitë një javore në Shqipëri. Një lojtar i rëndësishëm global në sektorin e BPO, ato janë të etur për të shtrirë disa nga operacionet e tyre në Ballkanin Perëndimor. Përfaqësuesit e tyre u takuan me aktorë dhe biznese të ndryshme në Tiranë, Shkodër dhe Elbasan dhe po shprehin interes të madh për të zgjeruar biznesin e tyre në Shqipëri. Vendimi përfundimtar do të merret në muajin shtator 2017. Përveç kësaj, edhe një investitor tjetër, Gen-Pact, është duke planifikuar që në muajin maj të kryejë një vizitë në Shqipëri. Kjo është një shenjë e mirë dhe flet për faktin që Shqipëria dalëngadalë po tërheq vëmendjen e kompanive BPO.

## "Do you have an idea?", një shfaqje e re televizive mbi sipërmarrjen

"Do you have an idea?" (A keni një ide?) eshte programi i ri televiziv që vjen në formatin e një shfaqje tërheqëse mbi sipërmarrjen në kanalin Vizion Plus, duke filluar nga muaji shkurt. Novatorë dhe ideatorë të ndryshëm vijnë në këtë shfaqje për të prezantuar produkte dhe ide të reja biznesi para një paneli me ekspertë dhe njerëz të biznesit. Programi sjell idetë fituese përgjatë disa faza mbështetjeje, duke i ndihmuar kandidatët që të përmirësojnë idetë e tyre të biznesit. Më pas, nëse rezultojnë të suksesshëm, fituesve ju ofrohet një kapital fillestar dhe mbështetje për realizimin e ideve të tyre të biznesit.

## Dita e Partnerëve

Gjatë "Ditës së Partnerëve" me datë 2 shkurt 2017, RisiAlbania mblodhi së bashku 26 nga organizatat e saj partnere. Kjo ofroi një mundësi për të reflektuar në lidhje me ecurinë e projektit deri më tani si edhe për të shkëmbyer ide në lidhje me bashkëpunimin e mundshëm në të ardhmen. Gjithashtu, ky aktivitet krijoi mundësinë që partnerët e projektit të shkëmbejnë informacion dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Zbatuar nga: HELVETAS Swiss Intercooperation ALBANIA | PARTNERSALBANIA FOR CHANGE AND DEVELOPMENT